



Pranuar / Dorezuar Punëhëno/Prodato Received/Delivered	22 - 11 2023	3	viti год Year
Organ /Mjesia Organ /Jedinstvo Org./Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtesa Punëq Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKPMSTKX	7065/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1326/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1326/2023, të datës 24.10.2023, të parashtruar nga ankueset të cilat e autorizojnë që t'i përfaqësoj ankuesja

kundër Vendimit me Nr. Port: 3233 të datës 06.10.2023 të u.d Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1326/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankueset

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.01/2023 me Nr. Prot: 3223 i datës 06.10.2023 i u.d Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë.

A r s y e t i m

Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit më datë 28.08.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 1227 me të cilin ka themeluar Komisionin për Emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet nën presion në përbërje: M.R-Kryesuese, A.A-anëtare, R.K-anëtare, S.R-anëtare dhe Z.I-anëtar, ndërsa sipas vendimit e Nr. prot: 780 të datës 03.03.2023 është bërë ndryshimi dhe plotësimi i pikës 1.1 të vendimit me Nr. 1227, ku në vend të kryesueses M.R është caktuar ankuesja H.J, kurse pikat tjera mbeten të pandryshuara.

Ministrja e Ministrisë së Ekonomisë më datë 15.09.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Port: 2986 me të cilin ka themeluar Komisionin për Emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet

nën presion në përbërje: H.J-Kryesuese, A.A-anëtare, R.K-anëtare, S.R-anëtare dhe Z.I anëtar me mandat tre (3) vjeçar, duke u përcaktuar që ky komision mund të kompensohet për funksion shtesë me plotësimin e kriterëve të përcaktuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Ankuesja _____ e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 02.02.2015 në pozitën "Zyrtare e Lartë Ligjore" në Ministrinë e Ekonomisë, ankuesja _____ pe punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.09/2023 të datës 06.01.2023 në pozitën "Udhëheqës i Inspektoratit të Energjisë" në Ministrinë e Ekonomisë dhe ankuesja _____ e punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.04/2022 të datës 27.04.2022 në pozitën "Zyrtare e Lartë e Sistemit të Ngrohjes dhe Gazit Natyrorë" në Ministrinë e Ekonomisë, të cilat janë edhe pjesë e Komisionit për emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet nën presion, ku i njëjti komision më datë 19.07.2023 ka parashtruar kërkesë për kompensimin për funksion shtesë tek zëvendësuesi e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë.

Sipas Vendimit me Nr. Prot: 2923 të datës 07.09.2023 është themeluar Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për kompensimin lidhur me Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë, ndërsa ky komision sipas rekomandimit të datës 27.09.2023, ka konstatuar se anëtarët e Komisionit për Emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet nën presion që janë nëpunës nga Ministria e Ekonomisë nuk i përmbushim kriteret në mënyrë kumulative sepse janë pjesë e institucionit ku është themeluar komisioni, ndërsa anëtarët Z.I dhe S.R i plotësojnë kriteret në mënyrë kumulative sepse janë anëtar të jashtëm respektivisht zyrtar të punësuar në institucion tjetër.

U.D e Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë më datë 06.10.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.Port: 3233, përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e ankuesve për kompensim sipas Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë, me arsyetimin se nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.

Ankueset, kundër Vendimit me Nr. Port: 3233 të datës 06.10.2023 të u.d Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë, më datë 24.10.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 6671/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Ekonomisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.10.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6671/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankueset në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1227 të datës 28.08.2020 të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit; Vendimin me Nr. Prot: 780 të datës 03.03.2023 të Ministres së Ekonomisë; Kërkesë e datës 19.07.2023 për kompensim për funksion shtesë nga Komision për Emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet nën presion; Vendimin me Nr. Port: 2923 i datës 07.09.2023;

Rekomandimin e datës 27.09.2023; Vendimin me Nr. Port: 3753 i datës 19.10.2023; Vendimin me Nr. Port: 3233 të datës 06.10.2023 të u.d Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë; Vendimin me Nr. Port: 2986 të datës 15.09.2023; Autorizimin e datës 24.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 27.10.2023; Akt Emërimit AE.Nr.09.2023 i datës 06.01.2023 për ankuesen A.A; Akt Emërimit AE.Nr.04/2022 i datës 27.04.2023 për ankuesen R.K-R; Akt Emërimit e datës 02.02.2015 për ankuesen H.J; Autorizim i datës 31.05.2023, 23.05.2023; Raportin me Nr. 1566 e datës 12.05.2023; Autorizim i datës 20.06.2023, 19.06.2023; Raportin me Nr. 1567 i datës 12.05.2023; Autorizim i datës 25.08.2023, 24.08.2023; Raportin me Nr. 2756 i datës 24.08.2023; Lista e pjesëmarrësve të Komisionit për Emërimit e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisje në presion datës 03.03.2023, 16.03.2023, 05.04.2023, 07.07.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lwndws tw dorwzuara nga palwt nw procedurw, konstatoi se ankesa e ankueseve, është e pabazuar, sepse:

Ankueset në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Prot: 3233 të datës 06.10.2023 të u.d Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, pretendojnë se ky vendim është nxjerr me shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit për Zyrtarët Publik, Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, ngase sipas Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë na takon kompensimi sikurse edhe anëtare të tjerë të këtij komisioni që ju është njohur e drejta e kompensimit.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueseve, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë kompensimin për funksionin shtesë, përkatësisht Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 38, paragrafi 6, të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me të cilat është përcaktuar se: *“Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi”,* si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë, me theks të veçantë dispozitat e nenit 5, 6, dhe 7, ku përcaktohet se: *Neni 5.1. “Nëse një zyrtar publik i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar publik nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme e zyrtarit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur. 2. Përyjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund*

të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: .1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar, neni 6.1. "Procedura për miratim të kompensimit Institucioni që themelon Bordin apo Komisionin sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, në Vendimin e themelimit parashih të drejtën për kompensim të anëtarëve të Bordit apo Komisionit dhe e përcjell tek Njësia përkatëse për ekzekutim", neni 7. 1. "Vlera e kompensimit 1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje."

Rrjedhimisht, në kuptim të bazës ligjore, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit të kontestuar me ankesë konkretisht Vendimin me Nr. Prot: 3233 të datës 06.10.2023 të u.d Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, për refuzimin e kërkesës së ankueseve për kompensim të funksionit shtesë, përkatsisht lidhur me angazhimin e ankueseve në Komisionin për Emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet nën presion, dhe konstatoi se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë mbi bazën e konstatimit të plotë të gjendjes faktike dhe më zbatim të drejtë të dispozitave materiale, pasi që nga provat e lëndës rezulton se Komisioni për Emërimin e trupave për vlerësim të konformitetit për pajisjet nën presion, është themeluar brenda Ministrisë së Ekonomisë pra në institucionin ku ankueset janë të punësuar, si rrjedhojë pas këtyre konstatimeve rezulton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueseve, ngase në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kërkesat ligjore për kompensim të funksionit shtesë siç është përcaktuar me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Bazuar në at që u konstatua si më lart, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVË
Lënda, A.nr.1326/2023, datë 22/11/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

